

Sinjalizime

Ekskluzive | Konflikti për rrugën në Brezovicë përfundon me armë – 65-vjeçari dyshohet se kërcënoi tre persona me pistoletë



Sinjali.com

06 Gusht 2026 10:03



Një konflikt i pazakontë në Qendrën e Skijimit në Brezovicë ka përfunduar me ndërhyrjen e Policisë, pasi një 65-vjeçar dyshohet se ka kërcënuar me armë zjarri tre persona gjatë një mosmarrëveshjeje për kalimin në një shteg malor.

Sinjali mëson se i dyshuari është Nusret Haziri rreth 65-vjeç, ndërsa viktimat të rastit janë M.Rr rreth 37-vjeç, H.S. rreth 48-vjeç dhe M. M. rreth 40 vjeç.

Sipas burimeve, ngjarja ka ndodhur pasditen e 5 gushtit, rreth orës 16:30, në afërsi të repetitorit në Qendrën e Skijimit në Brezovicë.

Tre viktimat po lëviznin me kuajt e tyre në një shteg të ngushtë malor, kur kanë hasur në të dyshuarin, i cili po ashtu ndodhej aty me kalin e tij. Sipas raportimit, ai kishte lënë kalin në mes të rrugës dhe kishte refuzuar ta largonte për t'u hapur rrugë.

Mosmarrëveshja verbale mes palëve ka eskaluar, kur i dyshuari dyshohet se ka marrë një pistoletë që e kishte pranë, e ka drejtuar në drejtim të tre personave dhe i ka kërcënuar, duke përdorur edhe fjalë fyese.

Lidhur me rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit, i cili ka urdhëruar që ndaj Nusret Hazirit të caktohet masa e ndalimit për 48 orë.

Rasti është iniciuar për veprat penale *"Kanosje me armë zjarri"* dhe *"Mbajtje e paligjshme e armës"*, ndërsa hetimet janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/


Brezovica

kërcënim

Konflikti

pistoleta

Të tjera:



Ekskluzive | Konflikti për një banesë përfundon me rrahje brutale tek "Erta Invest" në...

Ekskluzive



Reagojnë nga Shqipëria, Majko: Konflikti shqiptaro-serb është një hap larg

Politikë



Publikohen pamje nga vendi i ngjarjes ku mbeti i vrarë 15-vjeçari shqiptar, deklarohet...

Shqipëri



Lavrov: Duam që konflikti në Ukrainë të merr fund, por ne po i përgjigjemi Perëndimit

Evropë



Ministri Rashiq: Jam në mes të konfliktit Prishtinë-Beograd

Politikë



Sllovenia thërret në bisedë ambasadorin serb pas deklaratave të Vuçiqit për Kosovën

Rajon



E rëndë në Ukrainë: Raketat ruse vrasin më shumë se 30 civilë në një stacion treni në...

Botë



Biden 'aspak' i shqetësuar se komentet e tij për ndryshim pushteti në Rusi mund ...

Botë

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuria dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Fakte
Të tjera